



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA PEQIN

Kryetari i Bashkisë Peqin

Nr. 335 Prot

Peqin, më 6 qershor 2026

Urdhëresë

Nr. 52 Datë 6.02.2026

Mbeshtetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në fuqi", nenit 6 të ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 "Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", shkresës nr.902/1 prot datë 09/02/2026 të Ministrisë së Bujqësisë, Akt Ekspertimit Paraprirak të Institutit të Ndërtimit me nr.719/5 prot datë 05.11.2025, urdheroj si më poshtë :

1. Ndalimin e qarkullimit për një kohë të pacaktuar të mjeteve motorrike me tonazh mbi 3,5 ton në Uren e Digës Cengëllaj mbi shtratin e lumit Shkumbin .
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Policisë Bashkiake pranë Bashkisë Peqin .
3. Kjo urdhëresë hyn në fuqi menjëherë .

Kryetari i Bashkisë





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT NË FUSHËN E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

Nr. 902/ prot.

Tiranë, më 03.01.2026

Lënda: Mbi masat për sigurinë e urës në digën Çengelaj.

BASHKISË PEQIN

Peqin

Për dëjani:

KOMISARIATIT TË POLICISË PEQIN

Peqin

DREJTORISË VENDORE TË POLICISË ELBASAN

Elbasan

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHETIT

Tiranë

DREJTORISË SË UJITJES DHE KULLIMIT Durrës

Durrës

Në vijim të shkresës sonë Nr. 902, datë 28.01.2026 dhe takimit të datës 5.2.2026, të zhvilluar në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me përfaqësues të Bashkisë Peqin, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Institutit të Ndërtimit dhe Drejtorisë së Ujitjes dhe të Kullimit Durrës, në lidhje me masat, që duhet të ndërmerren për të garantuar sigurinë e urës pranë digës Çengelaj, bazuar në fushën e përgjegjësisë të institucioneve të sipërcituara, shprehemi si më poshtë:

Bazuar në Raportin Paraprak Nr. 719/5, datë 5.11.2025 të Institutit të Ndërtimit "Inspektim në Terren i Objektit Ura mbi Digën Çengelaj, Bashkia Peqin", (bashkëlidhur), që rekomandon si masë të menjëhershme ndalimin e kalimit të mjeteve të tonazheve mbi 3.5 ton, kërkojmë:

- Nga Bashkia Peqin, me mbështetjen e Komisarariatit të Policisë Peqin, të bëhet vendosja kufizuesve (biloqe betoni) në të dy anet, në hyrje dhe dalje, të urës për pengimin e kalimit të automjeteve mbi 3.5 ton si dhe monitorimi i vazhdueshëm zbatimit të kësaj mase në vijmësi.

- Nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Durrës, të bëhet monitorimi i masave për sigurinë e kësaj ure dhe për çdo rast të veprimeve, që çënojnë sigurinë e saj dhe masat e ndërmarra nga Bashkia Peqin, të informojë institucionet përkatëse.

Për një zgjidhje të qëndrueshme, është e nevojshme që Bashkia Peqin të angazhohet për mundësimin e financimit të projektit të ndërtimit të një ure të re, ndërsa, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Durrës në bashkëpunim me Institutin e Ndërtimitit, pas kryerjes së analizës së thelluar të qëndrueshmërisë së digës Çengelaj, të hartoj detyren e projektimit për të vijuar me hartimin e projektit të rikonstruksionit të plotë të Digës Çengelaj dhe urës së shërbimit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dritan Palnikaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT
DREJTORIA E KONFORMITETIT AKT EKSPERTIZAVE DHE
PROJEKTEVE

Nr. 114/ Prot.
15

Data: 27/11/2025

RAPORT PARAPRAK

INSPEKTIMI NË TERREN I OBJEKTIT:
URA MBI DIGËN ÇENGELAJ, BASHKIA PEQIN

KOORDINATAT: 41° 2'50.91"N, 19°51'6.76"E



[Signature]

[Signature]

I.VENDNDODHJA E OBJEKTIT



Objekti ndodhet në Çengelaj, Bashkia Peqin ka gjerësi dhe gjatësi gjeografike $41^{\circ} 2'50.91''N$, $19^{\circ}51'6.76''E$, sipas koordinatave Google sikurse tregohet edhe në pamjet e mësipërme.

2.2. Përshkrimi i Dëmtimeve

Vepra ka çedime në disa pila/këmbë ku mbështetet dhe ura, këto çedime vijnë që nga bazamenti i pilave, shkak i gërryerjes së bazamentit nga uji.

Këto ulje/çedime duken me sy të lirë, duke filluar në krahun e djathtë të rrjedhës së Lumit Shkumbin.

Pilat me nr. 4, 5, dhe 6 janë të dëmtuara me ulje/çedime, çedimet janë si në planin vertikal dhe atë horizontal, çka duken qartë dhe në (foto 2,5,6,7,8,9).

Pila me nr.6, ka dhe çarje të betonit me kënd 45° në të dyja anët e saj, çka përbën një problem serioz, pasi dhe vetë struktura punon në shtypje dhe jo në përkulje (foto 10,11,12).

Betoni në të gjithë veprën ka degradim si efekt i kohës së gjatë të shfrytëzimit si cilësia e materialeve dhe zbatimi i punimeve, në ato vite të ndërtimit të veprës (foto 16,17,18,19,20,21,22).

Në disa zona në trurët e urës, soletonet, konsolat, vërehen efekte të korrodimit të hekurit të këtyre strukturave (foto 16,17,18,22,23).

3. KONKLUSIONE

Vepra ka çedime/ulje të mëdha, të cilat janë serioze dhe mund të çojnë në kolaps të urës si dhe digës, si një trup i vetëm.


Me qenë se vepra punon në shtypje/përmbysje si një mur mbajtës, pa lejuar fenomenin e përkuljes, betoni ka rezistencë të ulët në prapje, pra është amarf dhe jo duktil, ky beton mund të japi shpërthime të menjëhershme pa fazë elastike (foto 10,11,12).


Aktualisht në këtë urë kalojnë makina të tonazheve të larta, çka bie ndesh me urën e cila nuk është projektuar për kategori të tonazheve të larta por vetëm për shfrytëzimin e veprës deri në tonazh 3.5Ton, sipas dhe tabelës së vendosur në hyrje të urës (foto 1,2).


4. FOTO
















16



17



18



19